



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.663/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Joos&Krasniqi-Baze” SH.P.K- Junik , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Junik” (KK.J), më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.HEDHET, si e pa lejuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Junik” (KK.J), pasi që i njëjti OE konsiderohet si palë pa interes juridiko material në aktivitetin e prokurimit në fjalë.

II.VËRTETOHET, Vendimi i AK-së - Njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Junik” (KK.J).

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa grupit të operatorëve ekonomik ankues: “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan , hedhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan ,si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 14.09.2020 me nr. 663/20 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Joos&Krasniqi-Baze” SH.P.K- Junik , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë” me nr. të prok: 636-19-5225-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Junik” (KK.J), duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 4 , 6 , 7 , 52 , 56 , 59 , 108/A , 111 , si dhe nenin 116 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 15.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 25.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan ,

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE ankues:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, për te cilin pretendon se nuk i ka plotësuar te kërkesa lidhur me mjetet e gatshme ne banke ne vlere prej 300,000.00 euro, pastaj pretendon se nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me listën e pagave qe dëshmon se OE i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve, po ashtu pretendon se nuk i ka pajisjet për realizimin e projektit dhe se nuk e plotëson kërkesën nr. 13 lidhur me vlerësimin e riskut.

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues qe kane te bëjnë me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, ka dhëne sqarimet ne raportet paraprake me nr. 272/20, 281/20 dhe ne raportet tjera. Prandaj, eksperti shqyrtues konform rregullores se punës se OSHP-se, e njofton PSH-ne si çështje te gjykuar me pare “Res judicata” dhe po ashtu lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate te gjitha paqartësitë lidhur me dëshmitë e ofertës se OE te rekomanduar për kontrate janë sqaruar dhe te njëjtat dëshmi janë te ngarkuara ne sistemin e e-prokurimit.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, konkretisht arsyes se eliminimit te dhëne ne letrën standarde, dhe se AK-ja, ne kundërshtim ne dispozitat e LPP-se, konkretisht duke u nisur nga afati i përcaktuar ne vendimin me nr. 1149/19, se ndalesa për pjesëmarrje ne aktivitete te prokurimit ka skaduar me datën: 18.05.2020 dhe se me vet faktin qe ka skaduar është dashur qe oferta jone te rivlerësohet dhe te konsiderohemi palë e barabarte ne këtë aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se periudha ne te cilën OE ankues i është ndaluar pjesëmarrja ne aktivitete te prokurimit ka qene nga 19.11.2019 deri me 18.05.2020, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pavarësisht se i njëjti është apo nuk është i përgjegjshëm është dashur te vlerësohet oferta e tij.

Për te njëjtën çështje OE ankues ka ofruar dy interpretime te KRPP-se lidhur me efektin e diskualifikimit te operatoreve ekonomik nga një aktivitet i prokurimit dhe mbi bazën e interpretimeve te KRPP-se, pretendon se i është mohuar e drejta ne këtë aktivitet te prokurimit, konkretisht është diskriminuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe ky aktivitet i prokurimit të rivlerësohet, megjithatë sqaron se mbetet në diskrecion te panelit shqyrtues vendosja, për faktin se ka një vendim me nr. 281/20 te datës: 12.06.2020, me te cilin OE ankues është shpallur palë pa interes juridik e material.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 28.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në si me poshtë:

Ju njoftojmë se AK-Komuna Junik, lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues , pajtohem i pjesërisht, sepse ne si AK nuk pajtohem i që lënda të kthehet ne rivlerësim pasi që kemi respektuar vendimin e OSHP-së, konkretisht paragrafin (ii) të vendimit nr. 100/111/20, të pranuar me datë 18.03.2020 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit ku jemi të njoftuar se OE në fjalë bazuar ne vendimin me numër 1149/19 është palë pa interes sepse OSHP e ka vendosur ne listën e zezë dhe meqenëse nuk kemi pranuar ndonjë vendim tjetër ne kemi

vepruar konform këtij vendimi. Prandaj, pajtohem që lidhur me këtë lëndë Organi Shqyrtues Prokurimit të vendos dhe ne si AK-Komuna Junik do ta respektojmë çdo vendim të OSHP-së.

Po ashtu, lidhur me raportin e ekspertit ju njoftoj se keni ngatërruar emrin e operatorit Ekonomik ankues dhe disa çështje tjera teknike.

Ju faleminderit.

Operatori Ekonomik, me datë: 25.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontrate, nuk i ka plotësuar kërkesat lidhur me mjetet e gatshme në banke në vlerë prej 300,000.00 euro, dhe pretendimin tjetër se i njëjti OE nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me listën e pagave që dëshmon se OE i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve, po ashtu pretendon se nuk i ka pajisjet për realizimin e projektit dhe se nuk e plotëson kërkesën nr. 13 lidhur me vlerësimin e riskut.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se janë dhënë sqarimet në raportet paraprake dhe vendimet PSH 831/19, 100,111/20, 272/20, 281/20. Prandaj, konform Rregullores së punës së OSHP-së, pretendimet e lartcekura janë gjykuar me par nga paneli shqyrtues dhe këto tani me konsiderohen si “Res judicata” dhe po ashtu lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate të gjitha paqartësitë lidhur me dëshmitë e ofertës së OE të rekomanduar për kontrate janë sqaruar dhe të njëjtat dëshmi janë të ngarkuara në sistemin e e-prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se me vendimin me vendimin numër 831/19, paneli shqyrtues ka konstatuar se OE “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan, është i pa përgjegjshëm në disa pika, duke konstatuar se i njëjti OE nuk ka plotësuar disa kërkesa të dosjes së tenderit, andaj duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1 pika 26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blerim Dina



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK/ -“KK-Junik ” (KK.J),
- 1x1 / OE/ - “Arfa Group & Euroasphall” SH.P.K – Deçan,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.